



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 23.06.2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1261\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 1, Nenit 15 , dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Rregulloren (BE) nr. 1227/2011 (REMIT) e Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Kërkesës nga Këshilli Ministror i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE) për transpozimin/adoptimin e rregullës REMIT 2018 /01/MC –EnC nga Palët Kontraktuese të SKE.

**në seancën e mbajtur me datë 23.06.2020, nxori këtë:**

## **VENDIM**

**I. MIRATOHET dokumentit *Rregulla për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me shumicë***

### **Arsyetim**

- Në ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Neni 1, paragrafi 2 thuhet: “Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, ...”
- Është kërkesë nga Këshilli Ministror i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (SKE) për transpozimin/adoptimin e rregullës REMIT 2018 /01/MC –EnC nga Palët Kontraktuese të SKE e cila parasheh implementimin e një forme të lehtë të rregullës REMIT.
- REMIT në EU është adoptuar në vitin 2011, ndërsa nga viti 2018, SKE ka filluar me përgatitjen për REMIT për Palët Kontraktuese ku edhe është përgatitur një kornizë bazë (template) për rregullën. Janë mbajtur shumë takime (punëtori) për të sqaruar përgatitjen e rregullës dhe implementimin e saj nga Palët Kontraktuese.
- ZRRE ka përgatitur versionin e përshtatur sipas formatit të SKE për Palët Kontraktuese, duke marrë parasysh edhe legjislacionin vendor.



- Rregulla përcakton kriteret që ndalojnë praktikat abuzive që ndikojnë në tregjet e energjisë me shumicë, të cilat janë koherente me funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike. Rregulla përshkruan: ndalimin e tregtimit dhe detyrimin për publikim të të dhënave; monitorimin dhe regjistrimin e pjesëmarrësve në treg, informatat konfidenciale; mbikëqyrjen, hetimin dhe masat administrative.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit konsideron se dokumenti plotëson kriteret e nevojshme për kryerjen e obligimeve të cekura më lartë dhe është në harmoni me legjislacionin e sektorit të energjisë në Kosovë, dhe përmes këtij vendimi ka miratuar dokumentin ***Rregulla për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me shumicë***.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- ***Rregulla për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me shumicë***

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së,

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar